“ZOTI IM, PREJ TEJE BURON PAQJA..!”

NDËRGJEGJJA

JAM ME TETOVËN... EDHE ME POSTRIBËN!

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 19 - Nr. 9 (223), Shtator, 2021

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990

“Koha është kapital i kërkuesve të dijes dhe i dijetarëve!”

Qëllimi i këtyre rreshtave është te madhështia e Islamit në nxitjen e njeriut për të mësuar shkrim e lexim, për të shfrytëzuar kohën e për të lënë gjurmë qytetëruese për të mirën e njerëzimit!



MYFTIU PRITI THIRRËSIN ISLAM SHQIPTAR NË AMERIKË, H. BURHAN FILI

Gjatë takimit të ngrohtë, Myftiu falënderoi z. Fili për kontributet e mëdha në përhapjen e vlerave islame kudo nëpër botë, si një zë i urtë dhe i ekuilibruar, miqësor e mesatar, që bashkon dhe afron në mesin e besimtarëve, duke përhapur dritën e urtësisë islame, kudo e me këdo.

Nga ana e tij, H. Burhan Fili u shpreh i gëzuar për këtë vizitë dhe dha disa këshilla dhe udhëzime, që lidhen edhe me kujtimin e mirë të Hoxhës së madh shqiptar... **(f. 16)**

RRUGICAVE TË LAGJEVE TONA MUSLIMANE...

Këto janë lagje të vjetra, ku kryesisht banojnë muslimanë. Xhamia e Parrucës, ajo e Tophanës, pak më tutje ajo e “Dy Vajzave”, (pjesë e lagjes Shabanej), janë tre xhamitë e kësaj zone. Do të duheshin edhe dy-tri xhami të tjera në këtë kuadrat gjeografik, për të shërbyer si vende adhurimi për muslimanët e kësaj zone.., mirëpo, ca gjëra nuk janë më si dikur e, përtej kësaj, edhe ca frymëra që duhet të ndiqnin rrugën e së mbarës, diku janë penguar e diku kanë devijuar rrugë... **(f. 4)**

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

DITA NDËRKOMBËTARE E SHKRIM-LEXIMIT...

"Koha është si shpata, po s'e preve, të pret!",
si dhe: "Prej shenjave të hidhërimit të Zotit ndaj teje,
është edhe humbja e kohës!"

Ditën e sotme, 8 shtator 2021, bashkë me mikun tim të zemrës, shkrimtarin Xhahid Bushati dhe shokun e studimeve, teologun dhe thirrësin islam Lavdrim Hamja, diskutuam për librat, botimet e reja, studimet dhe botën e librit.

Është padyshim një hise elitare në pozitat e një rituali të heshtur e që vetvetiu përkufizon takimet, këshillimet dhe bashkëbisedimet tona të shpeshta.

Më 26 tetor 1966, Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara, në sesionin e 14-të të Konferencës së Përgjithshme të saj (ndryshe, UNESCO), shpalli 8 shtatorin e çdo viti si Dita Ndërkombëtare e Shkrim-Leximit dhe që u festua për herë të parë më 8 shtator 1967, në atë vit të zymtë, kur politika e vendit tim damkosi me vulën e ateizmit dhe luftës kundër besimit e fesë, Shqipërinë, mjerisht..!

Kjo datë, më solli në hatër një ndër kryeveprat e dijetarit dhe eruditit të shquar sirian, Shejkh Abdulfetah Ebu Gudeh (1336-1417), që titullohet: "Vlera e kohës tek dijetarët".

Në botimin e 10-të të kësaj vepre, Bejrut, 2002, autori shpjegon me detaje konceptin e kohës dhe shfrytëzimit të saj në Kuran, në fjalët e Hz. Muhamedit (paqja qoftë mbi të) dhe në gjurmët e dijetarëve të shquar muslimanë përgjatë historisë.

Ai shënon se: "Koha është kapital i kërkuesve të dijes dhe i dijetarëve" - (f.11), sikurse thekson se: "Koha është jeta e vetë jetës, mejdan i ekzistencës së njeriut, hapësira e hijes, qëndrimit, dobisë dhe përfitimit të tij!" - (f. 17)

Na mëson, siç kanë kështilluar të parët se: "Koha është si shpata, po s'e preve, të pret!", si dhe: "Prej shenjave të hidhërimit të Zotit ndaj teje, është edhe humbja e kohës!" - (f. 24)

Nga këtu, tingëllon mrekullueshëm fjala e tabiiut (brezi që pason brezin e sahabëve të Resulullahut) Amr ibn Abdikajs, kur dikush i tha: "Ndalu pak të flasim", e ai ia ktheu: "Ndaloje diellin!" - (f. 26)

Kohë para tij, sahabiu i ditur, Hz. Abdullah ibm Mesudi (r.a) thoshte: "Nuk jam penduar për gjë në jetë, si për atë ditë, që i ka perënduar dielli, më është afruar exheli e s'kam shtuar punët e mira!" - (f. 27)

Dhe, leximet në shënimet e grumbulluara nga dijetari Ebu Gudeh, rahmet pastë, të marrin për dore drejt disa realiteteve, ku sheh dhe prek prej afër shembullin e dijetarëve muslimanë, të cilët, me përkushtimin e tyre ndaj kohës, leximit e shkrimit, bënë mrekulli të gjalla, duke na lënë pas një trashëgimi të jashtëzakonshme, gatigati të pabesueshme, porse reale dhe ende e gjallë në vëllimet e panumërta që mbushin librotekat tona.

Ja dy shembuj:

1) Zotëria dhe mbreti i hafizëve, hoxha i muhadithëve, Jahja ibn Maini, që lindi në vitin 158 h. në Bagdad. I ati i la trashëgim një milion derhemë, të cilat i shpenzoi në kërkimin e hadithit, aq sa nuk i mbetën as një palë shapka për t'i veshur! - (f. 34)

Ali ibnul-Medini thoshte për të: "Nuk kam parë ndër njerëz, si ai! As nuk dijmë njeri, që nga koha e Ademit, të ketë shkruar nga hadithi, sa ka shkruar Jahja ibn Maini!

Ndërsa Merveziu thoshte: "E kam dëgjuar Jahja ibn Mainin që thoshte: Kam shkruar me dorën time një milion hadithe!" - (f. 35)

(Autori shpjegon me këtë rast se: "Muhadithët e konsiderojnë çdo lajm a fjalë të Resulullahut (a.s), a fjalë të sahablve, a të tabiive, a tefsir i termave të huaj, a fjalëve të panjohura, a të ngjashme, nëse ato transmetohen me zhinxhir, si hadithe. Ky numër (një milion), këtë kuptim ka!" - (f. 35)

Jahja ibn Maini ndërroi jetë në vitin 233 dhe u varros në Bakia. Fisi Hashim i nxorën shtratin mbi të cilin ishte larë trupi i Resulullahut (a.s), dhe mbi të u la. Kur ai vdiq, njerëzit thonin: "Ky është ai që largonte gënjeshtrën nga Resulullahu!" - (f. 37)

2) Imam Ibn Xherir Et-Taberi, hoxha i mufesirëve, muhadithëve dhe historianëve, imam i madh muxhtehid, i cili ishte një ajet prej ajeteve të përfitimit nga koha dhe shfrytëzimi i saj, aq sa veprat e tij - me krejt spikatjen dhe përsosmërinë e tyre -, arritën në një numër të habitshëm!

Jakut Hameviu në jetëshkrimin e Imam Taberiut, shkruan 56 faqe. Ndërsa Hatib Bagdadiu në veprën e tij: "Historia e Bagdadit", shënon, se: "... Imam Taberiu iu drejtua studentëve të tij: A jeni të zellshëm të shkruani tefsirin e Kuranit? E pyetën: Sa është përmasa e tij? Tha: Tridhjetë mijë fletë! Thanë: Me këtë përmasë, na shkon jeta para se ta sosim! Ai e përmblodhi në rreth tremijë fletë dhe ia diktoi atyre për shtatë vite, nga viti 283 deri në vitin 290..." - (f. 41-42)

Hatib Bagdadiu vazhdon: "Kam dëgjuar Es-Simsimiun që thoshte se Ibn Xheriri qëndroi dyzet vite duke shkruar çdo ditë nga dyzet fletë!" - (f. 43)

Vetëm dy veprat e tij të shquara: "Historia" dhe "Tefsiri", janë të botuara sot, i pari në 11 vëllime me përmasa të mëdha, ndërsa i dyti në 30 vëllime me përmasa të mëdha! - (f. 43)

Pastaj, autori shton: "Përllogarit pastaj pjesën e mbetur të fletëve të veprave të tij, që është 351 mijë fletë, për të mësuar sesa arrijnë veprat e këtij imami, që konsiderohej si një kompleks shkencor plot arte dhe si një shtëpi botuese përsa i përket shumësisë së botimeve të tij!..." - (f. 43-44)

Dhe, siç thotë Imam Ibnul-Xheuzi: "Libri i dijetarit është fëmija i tij përjetësues!" - (f.45)

Nuk deshta të zgjatem më shumë në këtë temë, porse qëllimi i këtyre rreshtave është te madhështia e Islamit në nxitjen e njeriut për të mësuar shkrim e lexim, për të shfrytëzuar kohën e për të lënë gjurmë qytetëruese për të mirën e njerëzimit!

Shkodër, 8 shtator 2021

"ZOTI IM, PREJ TEJE BURON PAQJA..!"

21 shtatori i çdo viti është përcaktuar nga
Organizata e Kombeve të Bashkuara si Dita botërore e Paqes!

Elhamdulilah, unë jam musliman dhe bota është më e sigurt! Kjo është esenca dhe zanafilla! Këtu qëndron thelbi dhe rrënjët e çdo mirësie, me të cilën është begatuar njerëzimi, nga dita e parë e krijimit të njeriut e deri më sot! Kështu do të jetë deri në ditën e fundit, për të cilën, i Dërguari i mëshirës dhe paqes urdhëronte: "Nëse po bëhet kijameti dhe në dorën e ndonjërit prej jush ka një fidan, le ta mbjellë atë!", duke na nxitur drejt shpresës, besimit e paqes, edhe në momentet më kritike për mbarë universin!

Pas çdo namazi, ne si muslimanë lexojmë dhikret e virdeve ditore që na i mësoi Resulullahu (paqja qoftë mbi të), ku fjalia e parë pasi i kërkojmë falje Zotit të gjithësisë, është: "Allahume Entes-Selamu ve minkes-Selam...", që do të thotë: "Zoti im, Ti je burimi i Paqtimit, prej Teje buron Paqja..."!

Me pak fjalë, më e pakta, pesë herë në ditë, Islami na edukon e na frymëzon drejt paqtimit dhe rrugëve të tij, duke u lartësuar ditë pas dite drejt asaj që Krijuesi ynë kërkon prej nesh në këtë jetë: të jetuarit në paqe, të prodhuarit paqe, të përhapurit paqe me krejt krijesat e Tij, me natyrën, me gjithësinë!

Le të punojmë me sa të kemi mundësi për të jetuar në paqe dhe harmoni me njëri-tjetrin, duke ruajtur mbi të gjitha dinjitetin dhe krenarinë e besimit dhe të fesë, shenjtërinë e jetës dhe atë të njeriut-mëkëmbës i Zotit në tokë, dijes, arsimimit, zhvillimit të mendjes dhe furnizimit të saj sipas udhëzimit hyjnor!

Të përpiqemi për të punuar me pastërti e dinjitet, të angazhohemi për të ruajtur e mbrojtur Tokën, nënën tonë të përbashkët, nga zjarret dashakeqe, nga shkatërrimet egoiste, nga mbjellja e farës së ligësisë, etj., që shpien drejt konflikteve dhe të papriturave të padëshiruara, prishjes së rendit dhe lëkundjes së ekuilibrave të ekosistemit!

Të angazhohemi me të gjitha forcat për t'u ndarë nga politikat hipokrite e servile, që prishin rendin mbi tokë, edhe duke përdorur kartën e fesë nëpërmjet njerëzve pa integritet, për të përçarë njerëzit mbi baza fetare, si një përpjekje e devijuar drejt shpikjeve të reja për të cilat nuk kemi nevojë, e për të cilat feja na mëson të ruhemi e të distancohemi!

Të japë secili diçka nga vetja e tij për paqen me dinjitet, duke falur mirësi dhe dashuri, mirëkuptim dhe heshtje, sidomos në familje, me fëmijët, me të rinjtë dhe farefisin!

Nuk mund të prodhojmë paqe sociale, nëse nuk e kultivojmë dhe e jetojmë atë në familje fillimisht, pastaj në rrethin e ngushtë familjar, e më pas në shoqëri, me shumë kujdes e plot përkushtim!

Fjala e mirë është paqe! Buzëqeshja e sinqertë është paqe! Heshtja e urtë është paqe! Mësimi dhe edukimi i udhëzuar është paqe! Ndihma në rast nevoje është paqe! Luftimi i së keqes në jetë është paqe! Kundërshtimi i keqpërdorimit të besimit është paqe! Përballja me tërë fenomenet e prishjes dhe devijimit në jetë është paqe!

Paqe me Zotin! Paqe me robin! Paqe me vetveten e me realitetet e përditshme, që gjithsesi mbeten më të dobëta sesa mundësia për të ndryshuar kaderin!

Shkodër, më 21 shtator 2021

Imam Muhamed Bardhyl Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

"

Ky shekull
është shekulli i Islamit!

Një fé, që nisi me fjalën e shenjtë:
"Lexo me emrin e Zotit tënd që krijoi (çdo gjë)" dhe shpalli si mision përmbyllës të krejt shpalljeve të historisë së njerëzimit: "Ne nuk të dërguam ty (o Muhamed), veçse mëshirë për krejt botët", si dhe u vulos me dëshminë e madhe historike të Hz. Muhamedit (paqja qoftë mbi të), ditën e hyrjes çlirimtar në Mekë pa derdhur asnjë pikë gjaku, kur para duarve i sollën të zënët rob prej armiqve të tij, të cilëve iu drejtua: "S'do t'ju them, veçse siç i tha Jusufi vëllezërve të tij: Shkoni se jeni të lirë!"; kjo fé, nuk ka nevojë për shfaqje dhune e terrori për t'i dëshmuar botës se ky shekull është shekulli i Islamit!

Shkodër, 11 shtator 2021

"

RRUGICAVE TË LAGJEVE TONA MUSLIMANE...

Para ca kohësh, bashkë me vëllaun tim Ervil Kuçi, po bënim një ecje meditive, nga Parruca drejt Tophanës e, prej andej në kthim, drejt Garucit, Zdrales, Çinarit të Hoxhë Dheut e në vazhdim... Është një ecje gati-gati rituale, që nuk e lëmë pas dore, ndoshta edhe si një lloj komunikimi në heshtje me atmosferën e lagjeve të vjetra muslimane, shpirtin e tabanit, prekjet e heshtura të gjyshërve e baballarëve që nuk janë më, por që esenca e gjurmës së tyre është diku aty...

Këto janë lagje të vjetra, ku kryesisht banojnë muslimanë. Xhamia e Parrucës, ajo e Tophanës, pak më tutje ajo e "Dy Vajzave", (pjesë e lagjes Shabanej), janë tre xhamitë e kësaj zone. Do të duheshin edhe dy-tri xhami të tjera në këtë kuadrat gjeografik, për të shërbyer si vende adhurimi për muslimanët e kësaj zone.., mirëpo, ca gjëra nuk janë më si dikur e, përtej kësaj, edhe ca frymëra që duhet të ndiqnin rrugën e së mbarës, diku janë penguar e diku kanë devijuar rrugë...

Teksa shkel në këto rrugica, është e pamundur të mos vëresh detaje, disa prej të cilave kam dëshirë t'i ndaj me ju, edhe si një mesazh publik drejtuar krejt muslimanëve të Shkodrës, por edhe mbarë bashkëqytetarëve të mi dhe përtej tyre.

1) Rrugicat e lagjeve muslimane, ndonëse janë trajtuar me indiferencë të plotë nga pushtetet e ndryshme të 30 viteve të fundit, (si në investime, projekte, studime urbanistike, ndërtime etj.), ngelen të pastra, rrezatojnë një frymë karakteristike që ndjehet natyrshëm teksa shijon ecjen e mbrëmjes mbi këtë tokë të shtrenjtë.

Ndoshta, është gjurma e besimtarëve, që ndër shekuj kanë shkelur mbi të, që herët në sabah, drejt xhamive, lutjeve e dhikrit... Ndoshta është teuhidi në zemrat e banorëve dhe salavatet në gjuhët e tyre... Ndoshta, gjallëria e lëvizjeve në muajin e agjërimit, vizitat e bajrameve a përcjellja e pritja e haxhilerëve...

Ndoshta, aroma e parfumeve të Natës së Mevludit Sherifë, leximet e Kuranit a ndenjat e burrave besimtarë me tespihë në duar, përreth oxhaqeve, me kafe turke e ilahi ashikësh të përvëluar për Allah e Pejgamber... Ndoshta, era e pastërtisë së ujit mbi gurët e oborreve, lulet e pemët karakteristike të bahçeve tona... Ah, bahçet e nanave me degërmi të bardhë e ibrikun e ujit, për të ujit e lagë çdo cep e gur, brenda e jashtë oborreve tona..!

Ndoshta, është gjurma e hoxhallarëve në ecjen e tyre plot hejbe e madhështi, modesti e përulje drejt xhamive, drejt pajtimeve, drejt lutjeve... Ndoshta...

2) Lagjet tona, rrugicat tona, janë amanet! Që do të thotë se, ne si muslimanë, si bashkësi qytetare, është e mira që tiparet e rrugicave tona, oborret, muret e tyre, dyert e larta të drunjta, dyert karakteristike, etj, t'i ruajmë e t'i trashëgojmë si vlerë qytetare, si tipar kombëtar dhe vlerë tradicionale shqiptare! Mos të lejojmë që lagjet tona të prishen, (a të na i prishin, siç kanë bërë deri më sot), duke u prishur me to edhe tradita, historia, shpirti e tabani ynë qytetar.

Nuk është larg vëmendjes tuaj Tabaku a Bexhisteni! I pari, lagjja e vjetër ish-bajrak i parë i Shkodrës. I dyti, tregu i famshëm historik, prej të cilit ka ngelur vetëm ndonjë foto bardh e zi, a emri në ndonjë libër historie, (autori i të cilit bart akoma sadopak qytetari e njerzillëk, sa për të mos mbuluar krejt gjurmët e qytetërimit islam të këtij qyteti)..!?

Si të thuash, për disa në këtë qytet, komunizmi ka ngelur i shenjtë, i shenjtërueshëm, edhe për fshirjen e gjurmëve islame dhe shkatërrimin a deformimin e tyre në këtë tokë!? Por, mos të harrojmë se, nga viti '90 e deri më sot, nuk ka më komunizëm, por diçka tjetër përtej tij, që përhap me shumë finesë, atë që s'e bëri dot zjarri e hekuri ndër ne!

3) Muslimanët shkodranë duhet t'i ruajnë e t'i mbrojnë vetë gjurmët e shekujve, traditat dhe trashëgiminë e tyre, në lagjet përkatëse. Nuk duhet të lejojnë përzierjen, shitjen, transformimin rrënjësor, deformimin a fshirjen e gjurmës së identitetit!

Sepse, devijimi nga tabani,



> "NDOSHTA, ËSHTË GJURMA E BESIMTARËVE, QË NDËR SHEKUJ KANË SHKELUR MBI TË, QË HERËT NË SABAH, DREJT XHAMIVE, LUTJEVE E DHIKRIT... NDOSHTA ËSHTË TEUHIDI NË ZEMRAT E BANORËVE DHE SALAVATET NË GJUHËT E TYRE... NDOSHTA, GJALLËRIA E LËVIZJEVE NË MUAJIN E AGJËRIMIT, VIZITAT E BAJRAMEVE A PËRCJELLJA E PRITJA E HAXHILERËVE...

SA TË SHIJON SHFAQJA E TË RINJVE ME NJËRI-TJETRIN, QË NUK E HARROJNË TABANIN E FAMILJES, QOFTË EDHE NË LOJËN E TYRE, TEKSA THËRRASIN ME TË MADHE: "PASHA ALLAHUN NUK PO BAJ HILE!"...

është rrezik për brezat që vijnë, për edukimin e tyre, për rrugëtimet e mëtejshme në jetë. Sepse, origjina, baza, themeli, tabani, janë të shenjtë, të patolerueshëm, të padiskutueshëm, të paprekshëm! Janë vlerë e shenjtë e trashëgimisë kombëtare!

Kësisoj, muslimanët duhet t'i mbrojnë vetë gjurmët e trashëgimisë së tyre shekullore, mos të presin t'ia bëjë këtë as qeveria, as Bashkia, as institutet e ndryshme të monumenteve të kulturës e të ngjashëm, që kur bëhet fjalë për trashëgiminë shekullore islame në këtë kohë, rrudhen e tjetërsohen, deformohen e stepen..!?

4) Sa të shijon ecja në rrugicat muslimane, ku aty-këtu, të shfaqen të rinj e të vjetër, që të japin selam, që ngrihen në këmbë me dorë në zemër, në shenjë respekti, që të pyesin: "Si ka kenë zotnia jote?", që të japin fytyrë, duke buzëqeshur me mirësinë tipike të muslimanit...

Sa të shijon shfaqja e të rinjve me njëri-tjetrin, që nuk e harrojnë tabanin e familjes, qoftë edhe në lojën e tyre, teksa thërrasin me të madhe: "Pasha Allahun nuk po baj hile!"...

Sa të shijon pëshpëritja e vajzave të reja, që teksa kthehen në shtëpi me prindët e tyre a me ndonjë prejt të afërmve më të mëdhenj, ruhen të mos e ngrenë zërin, plot edukatë e qytetari, ulin kryet e kalojnë me edukatë e qytetari, mbështjellë me hirkën e shenjtë të turpit, si bijat e Shuajbit urtak në komunikim me Musain fisnik...

Sa të shijon ecja në këto net vjeshte, në këto rrugë e rrugica të ujitura me dhikër e salavate, me qytetari muslimanësh e pastërti vlerash shekullore, që kalojnë brez pas brezi, si bekim, që Shkodra e ruan në zemër të saj, duke e shpërndarë plot krenari për këdo që shkel në këtë tokë të shtrenjtë morali e besimi, harmonie e bese..!

Imam Muhamed Bardhyl Sytari
Shkodër, më 14 shtator 2021

"EDHE LAJMËTARI I ALLAHUT, DAVUDI..!"

Islami është fé e punës së ndershme e të pastër, që sjell dobi dhe që e lartëson njeriun në shkallët e përkushtimit të kërkuar, bamirësisë së sinqertë, altruizmit e ndihmesës ndaj familjarëve, nevojtarëve, shoqërisë.

Ka thënë i Dërguari i Allahut, Hz. Muhamedi (paqja qoftë mbi të): "Të marrë ndonjëri prej jush një litar dhe të vijë me një krah dru mbi shpinë për t'i shitur, duke ia ruajtur Allahu fytyrën e tij, është më mirë sesa të lypë prej njerëzve; i dhanë a e dëbuan!".

Sa e thellë është kjo këshillë, që e lexoj me vëmendje, duke vëzhguar nëpërmjet rreshtave të saj nxitjen që Islami i bën individit musliman për të punuar e jetuar me dinjitet, jo si parazit e barrë mbi kurrizin e familjes, shoqërisë e institucioneve!

Islami është fé e punës së ndershme e të pastër, që sjell dobi dhe që e lartëson njeriun në shkallët e përkushtimit të kërkuar, bamirësisë së sinqertë, altruizmit e ndihmesës ndaj familjarëve, nevojtarëve, shoqërisë.

Fakti që në Kuran janë përmendur shumë pejgamberë, të cilët janë shquar edhe për zanate të caktuara dhe janë angazhuar me punë nga më të ndryshmet, si: metalpunues, zdrukthëtar, çoban, ndërtues, administrator i ekonomisë e deri tek udhëheqës i shtetit, do të thotë se Islami na fton ta shfrytëzojmë kohën e të punojmë me krejt aftësitë që na janë dhënë e ato që kemi fituar, në kërkim të përsosmërisë në atë punë që bëjmë, në kërkim të rizkut hallall e nëpërmjet tij, të pëlqimit të Allahut të Madhëruar për jetën tonë, për të qenë secili ndërtues e kontribues për të mirën e zhvillimin shoqëror.

Të jetuarit në kurriz të tjetrit, humbja e kohës, qoftë edhe duke qëndruar në xhami, në një kohë jashtë namazeve të përcaktuara, dembelizmi, zgjimi nga gjumi pas lindjes së diellit, mungesa e korrektësisë në punë, mungesa e përgjegjësisë në raportet hallall-haram në punën që kryejmë, kopracia, zemra e ngushtë, mungesa e vullnetit etj., nuk përputhen me frymën e Kuranit dhe shembullin e Resulullahut (a.s.) në jetë!

Përndryshe, si ta lexojmë domethënien e fjalës së madhe: "Nuk ka ngrënë njeri ushqim më të mirë se ai i fituar nga puna e dorës së tij! Edhe lajmëtari i Allahut, Davudi, ushqehej nga puna e dorës së tij!", me të cilën Resulullahu (a.s) na nxit drejt punës, edhe po të jetë ndonjëri prej nesh mbret, si Davudi (a.s)!

Imam Muhamed Bardhyl Sytari
Shkodër, 17 shtator 2019 - 2021

Dr. Mustafa Mahmud

NDËRGJEGJJA

Miku im tha: Ju flisni për ndërgjegjen me shenjtëri, sikur të ishte një gjë absolute, megjithëse ajo është prej prodhimeve shoqërore, monedhë bakri, jo më shumë, që është stampuar, shkrirë dhe derdhur në furrat e marrëdhënieve shoqërore. Ajo tek ne është diçka që ndryshon për nga dispozitat dhe disiplinat, sipas interesave rrjedhëse. Vlera e cila na bën dobi, themi për të se është e mirë, ndërsa vlera e cila na dëmton, themi për të se është e keqe, edhe sikur kjo vlerë të jetë vetë dëlirësia, për të cilën kapeni fort, si sytë tuaj.

Me qetësi i thashë: Po, ky është mendimi i filozofëve materialistë, për aq sa kam dëgjuar; se ndërgjegjja është pushtet privues dhe pengues, që ka lindur nga shkaqe shoqërore. Thjesht, arritje eksperience, që dallon nga një person në tjetrin, nga një kohë në tjetrën dhe nga një popull në një popull tjetër.

Kjo është fjala juaj! Por, e vërteta është krejt ndryshe.

E vërteta është, se ndërgjegjja është dritë, që Allahu e ka vendosur në natyrën tonë, është tregues, argument dhe busull me të cilën lindim. Na orienton drejt të vërtetave dhe çdo rol i përvetësimeve shoqërore, është të pastrojë xhamin e kësaj busulle dhe ta lëmojë kristalin e saj.

Për këtë gjë, ne kemi fakte që na mbështesin dhe ua mbyll gojën fjalëve tuaja.

Shiko botën e kafshëve, që nuk kanë shoqëri. E shikon macen, që kryen nevojën fiziologjike, pastaj rrotullohet për ta mbuluar me dhé jashtëqitjen e saj. Në cilën shoqëri e ka mësuar macja këtë instinkt?

Si e bën dallimin mes jopastërtisë dhe pastërtisë?

Ti e sheh macen, që të vjedh peshkun, e nëse e kap dhe e qëllon në kokë, ajo ulë kokën dhe shikimin e saj, duke e ndjerë qartë gabimin.

I shikon duke luajtur me fëmijët në shtëpi, e kur thyen vazon gjatë lojës, atëherë çfarë ndodh? Ajo ikën me të shpejtë e frikësuar dhe fshihet poshtë karrigeve, ndërkohë që ajo e ka kuptuar se ka gabuar.

Të gjitha këto dukuri dhe tipare janë ndërgjegje.

Në mbretërinë e maceve nuk ka shtysa për të lindur ndjenjat, madje as që shohim asgjëkund shoqëri macesh.

Sjelljet besnike të "bashkëshortësisë" tek pëllumbat.

Fisnikërinë e kalit në lidhjen e tij me shokun e tij deri në vdekje.

Krenarinë e luanit dhe mos sulmimin e presë së tij nga prapa.

Turpërimin e devesë dhe tërheqjen e saj nga kryerja e marrëdhënieve intime me femrën, nëse nuhat se dikush po e vështron.

Pastaj, ajo ngjarja shumë domethënëse, të cilën e panë shikuesit në cirkun kombëtar të Kajros, kur luani u hodh mbi stërvitësin Muhamed El-Hulvi nga prapa, ia nguli kthetrat në shpatull dhe i shkaktoi plagë vdekjeprurëse.

Pjesën tjetër të ngjarjes e tregojnë punonjësit e cirkut. Si e ndaloi luani veten prej ushqimit. U mbyll në kafazin e tij dhe nuk dilte jashtë. Si e transportuan (e çuan) në një kopsht tjetër kafshësh, i ofruan një femër (luaneshë) për të luajtur me të, dhe ai e qëlloi dhe e largoi. Vazhdoi në këtë gjendje "agjërimi" dhe refuzimi të ushqimit derisa iu vërsul shputës së tij mëkatare dhe ngeli duke e shqyer, derisa u gjakos dhe ngordhi!

Kafshë, që vetëflijohet, si pendesë dhe dëlirësi për krimin e saj!

Prej çfarë shoqërie në botën e kafshëve të egra i ka mësuar luani këto sjellje? A është në shoqërinë e kafshëve të egra, se sulmi ndaj njeriut është krim, që të bën të vetëflijohesh?

Ne këtu jemi përpara një fisnikërie, morali dhe ndërgjegjeje, që nuk e gjen tek njerëzit. Ne jemi përpara një dështimi të plotë të shpjegimit materialist dhe të përfytyrimit materialist të realitetit të ndërgjegjes!

Nuk ka shpjegim për atë që shikojmë, vetëm se çfarë thotë feja. Se, ndërgjegjja është dritë, që e ka vendosur Allahu në natyrën tonë dhe çdo funksion i përvetësimeve shoqërore duhet të pastrojë blozën e shpirtit dhe të shohë këtë dritë hyjnore.

Kjo është ajo, që ka ndodhur mes luanit dhe stërvitësit të tij; bashkëjetesa, dashuria reciproke dhe shoqërimi që e ka lëmuar këtë shpirt kafshe dhe ka zgjuar këtë shkëndijë mëshironjëse. E vëmë re luanin që hidhërohet, pendohet dhe vetëflijohet nga hidhërimi, sikur njeriu!

"Hallalli është i qartë dhe harami është i qartë...", siç ka thënë i Dërguari ynë (paqja e Allahut qoftë mbi të).

"Pyet zemrën tënde, edhe nëse njerëzit të japin përgjigje...".

Nuk kemi nevojë për fakultet teologjik, që të njohim gabimin prej të vërtetës dhe haramin prej hallallit. Allahu ka vendosur në zemrën e secilit prej nesh "fakultet teologjik".

Peshorja jonë nuk gabon dhe gjithçka që kërkohet prej nesh është të pastrojmë blozën e shpirtrave tanë prej mashtrimeve lëndore dhe prej epsheve të shumta, pastaj të shikojmë, të vështrojmë dhe të dallojmë pa shkop "eksperienca shoqërore", e kjo është drita e Allahut, emri i të cilës është ndërgjegje.

"O ju që keni besuar, nëse e keni frikë Allahun (jeni të përkushtuar ndaj Tij), Ai ju bën të dalloni (të vërtetën nga e gabuara)". – (Kur'ani, El-Enfal: 29)

Allahu i thotë në një hadith kudsij, susfistit (gnostikut) Muhamed ibn Abduxhebar: "Si e humb shpresën nga Unë, ndërkohë që në zemrën tënde është ambasadori dhe folësi në emër Tim!".

Ndërgjegjja është një e vërtetë e pandryshueshme vlerash morale themelore, edhe ato janë të tilla, të pandryshueshme, sepse vrasja e të pafajshmit nuk do të bëhet kurrë virtyt, asnjë ditë; kështu është edhe hajnia, gënjeshtra, bërja keq të tjerëve, imoraliteti, krimi, fëlliqësia, ashpërsia, egërsia, hipokrizia dhe tradhtia. Të gjitha këto janë të kundërtat e moralit të mirë dhe do të mbesin kështu, derisa Allahu ta trashëgojë tokën dhe gjithçka ka në të.

Dhe, kështu do të mbesin dashuria, mëshira, sinqeriteti, durimi, falja dhe bamirësia virtyte dhe kurrë nuk do të shndërrohen në krime, përveçse nëse prishen qiejt dhe toka, marrëzia të sundojë dhe mendja të mbarojë!

(Marrë nga libri:
DIALOG ME MIKUN TIM ATEIST)

Përktheu nga arabishtja
dhe përshtati në shqip:
Lavdrim Hamja

Dr. Ardian Muhaj, *historian*

JAM ME TETOVËN... EDHE ME POSTRIBËN!

Mbrëmë në darkë në spitalin e Tetovës u shpalos një tragjedi e dhimbshme me shumë viktima dhe me shumë pikëpyetje. Solidarizimi, lutjet, ngushëllimet për viktimat dhe urimet për të lënduarit e mbushën rrjetin si pasqyrë e ndërgjegjes dhe ndërgjegjësimit të shqiptarëve anembanë botës. Pothuajse të gjithë politikanët me sinqeritet apo për politesë shprehën solidarizimin dhe ngushëllimet e tyre. Mbrëmë e sot, të gjithë ishin me Tetovën, dhe kjo është e mrekullueshme. Edhe nesër e pasnesër të gjithë kanë me qenë me Nju Jorkun, e prapë kjo është e lavdërueshme...

Por, le të jemi edhe me Postribën. Ose më saktë, nëse ishim dje e sot me Tetovën dhe nesër e pasnesër me Nju Jorkun, duhet të jemi edhe sot me Postribën. Duhet të jemi me ata njerëz të vrarë, të djegur, të masakruar e të diskriminuar që nuk kishin vrarë, djegur, masakruar apo diskriminuar askënd. As komunistët e Tito-Enverit!

Në një mëngjes shtatori, si sot para 75 vitesh djemtë dhe burrat e Postribës në bashkëpunim dhe bashkërendim me intelektualët dhe klerikët e Shkodrës e Malësisë së Madhe e Dukagjinit u zgjuan me dëshirën dhe ëndrrën për ta bërë Shkodrën e më pas krejt Shqipërinë të lirë nga komunistofashizmi enverist.

Të armatosur iu drejtuan qytetit në orët e para të atij mëngjesi të 9 shtatori 1946 dhe zhvilluan veprime ushtarake ashtu si dinë të luftojnë fisnikët, të diturit, të mëshirshmit, postribsit, shqiptarët. Në disa orë luftime, arritën të depërtonin deri në thellësi të qytetit dhe të venë nën kontroll disa rrugë e zona kyçe. Megjithatë, sado e pabesueshme të duket, është e vërtetë se mbi 100 luftëtarë që luftojnë për disa orë rresht dhe përparojnë me sukses në qytet, nuk shkaktuan asnjë të vrarë, asnjë viktimë.

Ishte përpjekja dhe beteja e fundit sipas traditës shqiptare: të luftosh edhe me armë në dorë për bindjet dhe idetë e tua, dhe njëkohësisht të luftosh duke mbrojtur veten dhe kundërshtarin, duke mëshiruar e shmangur civilët dhe qytetarët, duke synuar lirimin e të burgosurve dhe jo lëndimin e gardianëve, duke kërkuar lirinë e Shqipërisë dhe jo dhunimin e shqiptarëve.

Qindra forca në aksion, orë të tëra luftë, suksese në frontin e përballjes dhe asnjë viktimë, asnjë i vrarë, asnjë i dhunuar. Luftë kreshnikësh, si në kohët e vjetra, kur të rinjtë përpara se të mësonin armët, kishin mësuar edukatën dhe respektin për njerëzit. Luftë ku njeriu mbetej njeri në çdo çast. Luftë ku trimi e kthente mbarë viktimën e tij dhe qante bashkë me familjarët e të vrarit për "fatin e keq që u ra në derë".

Megjithatë kundërshtarët që kishin përballë ishin krejt tjetër. Të frymzuar nga nji ideologji çnjerëzore, pa asnjë traditë shqiptare, ishin një përzierje njerëzish adhurues të fashizmit dhe komunizmit që u mundësonte nxjerrjen në pah dhe vënien në veprim të anës më të errët të qenies njerëzore, të barbarisë së pashembullt e të pashoqe. Njerëz pa zemër, pa tru. Njerëz çnjerëz, ose ndryshe komunistë shqiptarë e shqipfolës.

Përforcimet e forcave komunistofashiste nuk vonuan dhe mbas disa orë luftimesh fati i betejës ndryshoi rrjedhë. Tashmë komunistofashistëve të Enver Hoxhës u mbërritën forca të shumta në ndihmë nga garnizonet e afërta. Luftëtarët postribas nisën tërheqjen strategjike e cila ishte edhe pikënisja e masakrës që do të pasonte.

Barbaria komunistofashiste e la gjurmën e vet të përgjakshme në zonën e Postribës e përbërë prej rreth 15 fshatrash. U vranë dhjetëra, u arrestuan dhe u burgosën qindra dhe u persekutuan mijëra postribas, shqiptarë, qytetarë të Shqipërisë si reprezalje e barbarëve komunistofashistë. Nazistët gjermanë thuhej se në raste ekstreme bënin reprezalje ku për 1 gjerman të vrarë, vrisnin 10 kundërshtarë, dikush madje thotë 100. Deri edhe fashisti serb Aleksandër Vuciq kërkonte për 1 serb, 100 muslimanë të vrarë, por askush si barbarët komunistofashistë të Enver Hoxhës.

Në Postribë ata vranë dhjetëra postribas, safi shqiptarë për asnjë komunistofashist të vrarë. Dogjën dhjetra shtëpi dhe burgosën e persekutuan qindra e mijëra postribas, safi shqiptarë për asnjë të vrarë.

Prandaj, sot jam me Tetovën në mendje e në zemër... por jam edhe me Postribën. Jam me tetovarët, me postribsit, me të mirët, me të mëshirshmit, me fisnikët, me shqiptarët! Jam me të djegurit, jo me zjarrvënësit, as me zjarret!

KUR TË SHTOHEN BRENGAT DHE SHQETËSIMET, SHPESHTO KËTË THËNIE...

Naim Drijaj,
Imam - xhamia e Parrucës

Kur të të shtohen brengat dhe shqetësimet, shpeshto thënien e fjalës **“La havle ve la kuvete il-la bil-lah”**

Çfarë kuptimit ka kjo fjalë?

Ibn Abbasi (r.a) ka thënë: “Kuptimi i fjalës ‘La havle ve la kuvete il-la bil-lah’ është: Njerëzit nuk kanë mundësi të ndryshojnë veten, nuk munden të shtojnë adhurimet ndaj Allahut dhe punët e mira veçse me ndihmën e Allahut, gjithashtu nuk kanë forcë t’i braktisin gjynahet veçse me ndihmën e Tij.”

Kjo fjalë e zhvesh njeriun nga çdo lloj fuqie, pushteti dhe mendjemadhësie që mund ta kapë atë në çdo moment të jetës së tij.

Muslimani duhet t’i kushtojë rëndësi kësaj fjale duke e shtuar sa më shumë në jetën e tij, ngase kjo fjalë ka vlerë të madhe dhe shpërblimet e saj janë të shumta.

Vlera dhe rëndësia e kësaj fjale.

1. Është thesar prej thesareve të xhenetit.

Transmetohet se Pejgamberi (a.s) i ka thënë Abdullah ibn Kajsit: “O Abdullah ibn Kajs, Thuaj: “La havle ve la kuvete il-la bil-lah” sepse kjo është thesar prej thesareve të xhenetit. Kush e thotë këtë fjalë: “La havle ve la kuvete il-la bil-lah” kjo fjalë është ilaç për nëntëdhjetë e nëntë sëmundje, ku më e lehta prej të cilave është brenga.” Shprehja “La havle ve la kuvete il-la bil-lah” ka ndikim të madh në largimin e pengesave, mërzitjeve dhe vështirësive jetësore. Ajo e qetëson mendjen dhe zemrën.

2. Fshin gjynahet.

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Nuk ka njeri i cili thotë “La ilahe ilallah, Allahu Ekber, Subhanallah, Elhamdulilah, La havle ve la kuvete il-la bil-lah”, dhe nuk do t’i fshihen të gjitha gjynahet *(për qëllim janë gjynahet e vogla)*, edhe nëse janë sa shkuma e detit.”

3. Toka e xhenetit është tokë pjellore dhe mbillet me fjalët.

Transmetohet se kur Pejgamberi (a.s) e ka takuar Ibrahimin (a.s) në natën e Miraxhit ai i ka thënë: “O Muhammed, çoji selam nga ana ime umetit tënd dhe thuaju se xheneti ka tokë pjellore, por është djerr. Ajo mbillet kur besimtari thotë Subhanallah, Elhamdulilah, La ilahe il-lallah dhe Allahu Ekber!”

Në një transmetim tjetër është edhe fjala “La havle ue la kuvete il-la bil-lah”.

4. Ajo është “derë” prej dyerve të xhenetit.

Pejgamberi (a.s) i ka thënë njërit prej shokëve të tij: “A do të të tregoj për një derë prej dyerve të xhenetit? Thuaj: “La havle ue la kuvete il-la bil-lah”.

5. Me këtë fjalë mbrohemi nga shejtani.

Transmetohet nga Enes ibn Maliku (r.a) se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Kur njeriu del prej shtëpisë së tij dhe thotë: “Me emrin e Allahut, Allahut iu mbështeta dhe s’ka lëvizje e as forcë përveçse me dëshirën e Allahut”, i thuhet në atë moment: “U udhëzove, t’u plotësuan nevojat dhe je i mbrojtur.”

Prej këtij personi largohet shejtani. Ndërkaq një shejtan tjetër i thotë: “Si do t’ia bësh me këtë njeri, i cili është udhëzuar, i janë plotësuar nevojat dhe është i mbrojtur?”

6. Pranimi i namazit dhe lutjes.

Transmetohet nga Ubade ibn Samiti (r.a) se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Kush zgjohet natën nga gjumi dhe thotë: “S’ka të adhuruar tjetër përveç Allahut Një dhe të Pashoq, Atij i takon sundimi dhe falënderimi dhe Ai është i Plotfuqishëm mbi çdo gjë. Falënderimet i qofshin Allahut, i lartësuar qoftë Allahu, nuk meriton të adhurohet askush përveç Allahut, Allahu është më i madhi, s’ka ndryshim e as forcë përveç ndihmës së Allahut”, pastaj lutet dhe thotë:

“O Zoti im, më fal mua!” ose nëse lutet për diçka, do t’i pranohet lutja. E nëse merr abdest dhe falet, do t’i pranohet namazi.” Ibn Betali (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: “Allahu ka premtuar me gjuhën e të Dërguarit të Tij se kush zgjohet natën nga gjumi dhe gjuha e tij shpreh njëjësimin e Zotit të Tij, dhe thotë se vetëm Atij i takon sundimi, është mirënjohës për dhuntitë e Tij dhe e falënderon për to, e zhvesh Atë prej gjërave që nuk i përkasin duke e lartësuar, shfaq nënshtrimin dhe përuljen ndaj Tij duke e madhëruar Atë dhe i dorëzohet Atij duke treguar mangësinë e vet dhe nevojën për ndihmën e Tij dhe pas kësaj kërkon diçka nga Zoti i tij, do t’i jepet. E nëse fal namaz (nafile), do t’i pranohet...”.

7. Muslimanët së paku këtë fjalë e thonë 20 herë në ditë.

Pejgamberi (a.s) ka thënë:“Kur të dëgjoni muezinin përsëritni ato fjalë që thotë ai”. Umer ibn Khatabi (r.a) tregon se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Kur muezini thotë: “Allahu Ekber, Allahu Ekber”, thoni edhe ju: “Allahu Ekber, Allahu Ekber”. Kur muezini thotë: “Esh’hedu en la ilahe il-lallah”, thoni edhe ju: “Esh’hedu en la ilahe il-lallah”.

Kur muezini thotë: “Esh’hedu enne Muhammeden Rasulullah”, thoni edhe ju: “Esh’hedu enne Muhammeden Rasulullah”. Kur muezini thotë: “Hajja alas-salah, ju thoni: “La havle ve la kuvete il-la bil-lah”. Kur muezini thotë: “Haj’ja alel-felah”, ju thoni: “La havle ve la kuvete il-la bil-lah”. Kur muezini thotë: “Allahu Ekber, Allahu Ekber”, thoni edhe ju: “Allahu Ekber, Allahu Ekber”, kur muezini thotë: “La ilahe il-lallah”, thoni edhe ju: “La ilahe il-lallah”.

Nëse ju i thoni me zemër, meritoni xhenetin”. Kur muezini thotë “Eja në namaz!”, “Eja në shpëtim”, ne themi “La havle ve la kuvete il-la bil-lah”.

Ngaqë, nëse Allahu i jep personit forcë dhe sukses, atëherë ai i përgjigjet kësaj thirrjeje. Sa e sa njerëz janë të sëmurë, të shtrirë, e nuk kanë mundësi të dalin në xhami për t’iu përgjigjur kësaj thirrjeje!

8. Me këtë fjalë fitohen mirësi të shumta.

Ka ardhur një person te Pejgamberi (a.s) dhe i ka thënë: “Unë nuk po arrij të memorizoj diçka nga Kurani (nuk po më hyn asgjë në tru), por më trego (më mëso se çfarë të them) që të jem edhe unë sikur ju. Pejgamberi (a.s) i ka thënë:

“Thuaj: “SubhanAllah, Elhamdulilah, La ilahe il-lallah, Allahu Ekber, La havle ve la kuvete il-la bil-lahil-Alijjil-Adhim.” Ai i ka thënë: “O i Dërguar i Allahut! Këto fjalë janë për Allahun, po çfarë të them për veten (për t’u lutur)?” I Dërguari i Allahut i ka thënë: “Thuaj: O Allah, më mëshiro, më furnizo, më jep shëndet dhe më udhëzo!” Transmetuesi tregon se ky person i ka numëruar këto fjalë me dorën e tij (pesë për Allahun dhe të tjerat për veten). Kur i Dërguari i Allahut e pa atë duke vepruar kështu, pasi iku ky person, tha: “Ky e ka mbushur dorën e tij me mirësi të shumta.”

Një sqarim rreth kësaj fjale.

Shumë njerëz gabojnë në përdorimin e kësaj fjale duke e përdorur jo në vendin e duhur apo në mënyrën dhe për qëllimin për të cilin Allahu i Lartësuar dhe Pejgamberi (a.s) na ka urdhëruar që ta përdorim. Kjo fjalë është fjalë e kërkimit të ndihmës, nuk është fjalë e ngushëllimit. Andaj shumë prej njerëzve këtë fjalë e thonë kur goditen nga fatkeqësitë, si ngushëllim për veten, e jo si fjalë përmes së cilës kërkojnë ndihmë nga Allahu.



I Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë:

“Mësoni prej diturive sa të dëshironi, se pasha All-llahun nuk do të shpërbleheni për mbledhjen e diturive, derisa të punoni me to!”

(Ebul-Hasen El-Medini, nga Enesi)

ÇADI
REPUBLIKA E NIGERIT

Çadi, ose zyrtarisht 'Republika e Çadit', është një shtet që gjendet në Afrikën veriore-qendrore, pa dalje ne det. Çadi kufizohet me Libinë në veri, me Sudanin në lindje, me Republikën e Afrikës Qendrore në jug, me Kamerunin në jug-perëndim, dhe me Nigerinë e Nigerin në perëndim.

Çadi ka një sipërfaqe prej 1.284.000 km2, dhe një populsi prej 17.022.288 banorësh (Shtator 2021, sipas worldometers.info).

Kryeqyteti i vendit është **N'Dxhamína**.

GJEOGRAFIA

Terreni i vendit ka pamjen e një pellgu të gjerë, të kufizuar në veri dhe në lindje nga Rrafshnalta Ennedi dhe nga Malet Tibesti, të cilat përfshijnë Emi Koussi, një vullkan i fjetur që arrin në 3.414 metra mbi nivelin e detit. Liqeni Çad, sipas të cilit ka marrë emrin edhe vendi (fjalë e cila në gjuhën Kanuri do të thotë "liqen"), është ajo që ka mbetur nga një liqen i madh që zinte 330.000 kilometra katrorë të territorit të Çadit, 7000 vjet më parë. Edhe pse në shekullin e 21-të ky liqen mbulon vetëm 17.806 kilometra katrorë, dhe sipërfaqja e tij i nënshtrohet luhatjeve të mëdha sezonale, gjithsesi liqeni është ligatina e dytë më e madhe në Afrikë.

Ujitja natyrore atje është e limituar në lumenjtë Chari dhe Logone, me degët e tyre, që rrjedhin nga juglindja për në liqenin Çad.

KLIMA

Në Çad mbizotërojnë kushtet klimatike të shkretëtirës, të shoqëruara me temperatura të larta që mbizotërojnë në qendër dhe në veri të vendit, dhe të nxehta e të lagështa në jug të tij. Sezoni relativisht i ftohtë, në të cilin temperatura e ditës varion midis 29-35 °C, dhe temperatura e natës varion midis 13 °C - 16 °C, zgjat nga dhjetori deri në shkurt. Sa i përket sezonit të nxehtë, ai zgjat nga marsi në dhjetor, dhe madje deri në janar, ku temperatura gjatë ditës sillet rreth 38°C, kurse natën rreth 20°C. Temperatura absolute në Çad arrin më shumë se 50°C në qendër-perëndim, kurse minimumi absolut shkon nën zero, në netët e shkretëtirës veriore dhe të maleve Tibesti. Nga ana tjetër, shirat në pjesët veriore janë shumë të pakta dhe mjaft të rralla, me një normë vjetore prej jo më shumë se 10-20 mm në vit. Në shkretëtirën veriore niveli i shirave shkon nga 2-5 mm, duke u rritur drejt jugut të lagësht, ku normat vjetore variojnë midis 800-1200 mm, që bien në periudhën mes majit dhe tetorit.

GJUHA

Gjuhët zyrtare të Çadit janë arabishtja dhe frëngjishtja, por fliten mbi 100 gjuhë dhe dialekte të tjera. Për shkak të rolit të rëndësishëm që kanë luajtur tregtarët arabë shëtitës, dhe tregtarët e vendosur në komunitetet lokale, arabishtja çadiane është bërë një gjuhë shumë e

përdorur që shërben si urë ndërlidhëse mes komuniteteve të ndryshme në vend.

FEJA

Rreth tre të pestat e popullsisë së vendit janë myslimanë sunitë. Shumica e myslimanëve gjenden në veri dhe në lindje të Çadit. Islami atje erdhi shumë herët, dhe u pasua nga konvertimi në Islam i subjekteve kryesore politike të rajonit, siç ishin sulltanatet e Wadai, Bagirmi dhe Fitri. Islami është i mirëstabilizuar në shumicën e qyteteve të mëdha dhe kudo që gjendet popullsi arabe. Islami në Çad ka tërhequr një larmi të madhe të grupeve etnike dhe ka krijuar një unitet mes tyre, megjithëse nuk ka arritur në eliminimin e plotë të praktikave dhe zakoneve të ndryshme lokale.

Pak më shumë se një e pesta e popullsisë janë të krishterë, kryesisht protestantë ose katolikë romakë.

Pjesa e mbetur u përkasin besimeve pagane.

EKONOMIA

Çadi është një vend në zhvillim, ekonomia e të cilit bazohet kryesisht në prodhimet bujqësore dhe blegtorale. Në Çad prodhohet orizi, pambuku, misri, kallami i sheqerit, kikirikët, susami, çamçakëzi arabik, dhe disa lloje frutash si mangoja dhe portokalli. Çadi gjithashtu ka një numër të madh të lopëve, deleve dhe deveve, dhe konsiderohet burimi kryesor i mishit për vendet e Afrikës Qendrore dhe Perëndimore, produkt të cilin e eksporton edhe në pjesë tjera të botës.

Zbulimi i naftës në veri të Liqenit të Çadit çoi në një eksplorim dhe zhvillim të mëtejshëm, dhe në vitin 2003 Çadi filloi të prodhojë naftë, e cila shpejt u bë burimi më i rëndësishëm i ekonomisë së vendit. Gjithashtu në Çad ka depozita ari, të vendosura në pjesë të ndryshme të vendit. Depozitat e tjera minerale përfshijnë uraniumin, titanin dhe boksitin.

HISTORI

Siç e dëshmojnë zbulimet arkeologjike, rajoni i Saharasë lindore, nga Fez'zan, Bilma dhe Çad, në perëndim, e deri në luginën e Nilit, në lindje, kanë qenë mjaft të populluara në kohët neolitike. Ndoshta tipike për popullsitë më të hershme ishin 'banorët e shpellave me lëkurë të errët', të përshkruar nga Herodoti si 'banorët e jugut të Fez'zanit'. Historia etnografike e rajonit është ajo e modifikimit gradual të këtij stoku themelor. Ky modifikim u bë nëpërmjet infiltrimit të vazhdueshëm të elementëve nomadikë dhe të të sapo-arabizuarëve të bardhë afrikanë, që vinin nga veriu përmes Fez'zan dhe Tibesti (veçanërisht pas shekullit të 14 –të), nga lugina e Nilit dhe nga Darfuri. Sipas legjendës, vendi rreth liqenit të Çadit u pushtua fillimisht nga Sao. Ky popull i zhdukur tashmë, ndoshta përfaqësohet sot nga Kotoko, në vendin e të cilit (përgjatë brigjeve të Logone dhe Chari), në vitet 1950, u zbulua një kulturë mesjetare e shquar për punën në baltë dhe bronz.



Xhamia e Madhe - N'Dxhamína

Mbretëritë relativisht të mëdha dhe të sofistikuara politikisht të Sudanit Qendror ishin krijim i Amazigëve Saharianë (Berberët), të cilët tërhiqeshin drejt jugut, nga kërkimi i tyre i vazhdueshëm për kullota, dhe nga aftësia e tyre për të imponuar lehtësisht hegjemoninë e tyre në shoqëritë e ndara bujqësore autoktone. Ky proces u intensifikua me zgjerimin e Islamit. Ka indikacione për një emigrim të madh të Amazigëve paganë, në fillim të shekullit të 8-të, për në Sudanin Qendror.

Në shekullin e 2-të Hixhri (i 8-të e.j), në Çad u krijua mbretëria e parë islame. Emri i asaj mbretërie ishte Mbretëria e Kanemit, dhe shtrihej në verilindje të liqenit të Çadit. Ndikimi i saj u zgjerua në shekullin e 3-të Hixhri, dhe arriti të përfshinte të gjithë rajonin e Sudanit të Mesëm, derisa ra nën kolonializmin francez.

Në vitin 1920 vendi ra nën kolonializmin francez. Sundimi francez

Kryeqyteti N'Dxhamína

në Çad u karakterizua nga mungesa e politikave për unifikimin e territorit dhe nga modernizimi i ngadaltë në krahasim me kolonitë e tjera franceze.

Administrata koloniale në Çad nuk kishte staf të kualifikuar. Vetëm etnia Sara, e jugut, u qeveris në mënyrë efektive. Prania franceze në veri dhe në lindje të Çadit, që ishin zona islame, ishte vetëm sa për emër. Pas Luftës së Dytë Botërore, Franca i dha Çadit statusin e 'territorit përtej detit', dhe banorëve të tij u dha të drejtën për të zgjedhur përfaqësues në Asamblenë Kombëtare dhe për të krijuar një Kuvend të Çadit. Partia më e madhe politike asokohe ishte Partia Progresive e Çadit, selia e së cilës gjendej në gjysmën jugore të kolonisë. Çadit iu dha pavarësia më 11 Gusht të vitit 1960, dhe president i parë u zgjodh François Tombalbaye, që i përkiste etnisë Sara.

SI ERDHI ISLAMI NË ÇAD

Para ardhjes së Islamit në zona e Çadit, popullsia vendase ndiqnin fetë pagane. Në shekullin e parë të Hixhretit (shek. 7-të e.j), atje mbërritën ushtritë islame, që mbartnin me vete besimin islam dhe dritën e qartë, e cila filloi të përhapej në Çad, por edhe në zonat rreth e rrotull tij.

Doktor Abdurrahman El-Mahi thotë: "Ardhja e Islamit në Çad daton që nga kohët e largëta, qëkur muslimanët e parë mbërritën në pellgun e liqenit Kuvar (Çadi i sotëm), që nga mesi i shekullit të parë të Hixhretit, që përkon me shekullin e shtatë të erës sonë, më saktësisht viti 46 H, ose 666 e.j."

Në lidhje me mbërritjen e ushtrisë Islame në veri të rajonit të Çadit, veçanërisht në qytetin Kuvar, nën komandën e Ukbe ibn Nafi, pas marrjes nga ana e tyre të qyteteve të Libisë, shkrimtari italian Ettore Rossi thotë: "Tregohet se Ukbe ibn Nafi depërtoi deri në Veddan dhe Gadamis, dhe i pyeti banorët e atyre vendeve për zonat e jugut, dhe ata i përmendën Xherme-n, atë qytet të madh në Fezzan, kështu që ai e mori Fezzanin dhe më pas mësyu drejt jugut për në Kavara, derisa mbërriti në një vend të quajtur Ajn El-Feres."

Kështu mbërriti feja Islame në Çad, fe e cila u përhap me shpejtësi në kontinentin afrikan, falë mirësisë së Allahut të Madhërishëm, pastaj edhe falë natyrës së kësaj feje, e cila i shkon përshtat natyrës njerëzore... gjë e cila bëri që ajo të pranohej me lehtësi nga paganët afrikanë.

Doktor Refet Ganimi, në lidhje me këtë temë, thotë: "Islami u përhap me shpejtësi në Afrikë dhe pa ndonjë vështirësi që mund të përmendet, sepse mbartësit e Islamit e konsideronin veten e tyre mbartës të Mesazhit të Rregullimit dhe të Paqes. Ata ishin model dhe shembull në sjelljet e tyre, gjë e cila i tërhoqi paganët afrikanë ta përqafonin fenë islame, fenë e atyre arabëve të cilët nuk besonin në teorinë e supremitetit të racave, apo në ekzistencën e racës së pastër.., por që u martuan dhe u përzien me afrikanët. Fiset arabe udhëtuan dhe u vendosën në Saharanë e Madhe, dhe ndërtuan ura lidhjeje mes afrikanëve të veriut, të zonës qendrore, të lindjes dhe të perëndimit të kontinentit."

Përgatiti:
Msc. Arta Ujkaj, *teologe*

https://www.britannica.com
https://en.wikipedia.org
https://www.aljazeera.net
https://ar.wikipedia.org
https://www.marefa.org
Musa Jusuf Aisa Idris: Vākia' ed-Da'ue el-Islāmîje fi Tshād

NEVOJA E PËRZGJEDHJES SË NJË SHEMBULLI PËR TA NDJEKUR

Njerëzit vazhdimisht, duan të bëjnë përshtypje te miqtë e tyre dhe të përshtaten me grupin me të cilin shoqërohen. Historia përsërit veten, e ne shpesh përdorim shprehjet: "Trego me kë rri, të tregoj kush je! ose "Molla e kalbur, kalb edhe të tjerat". Nisur nga këto dy shprehje, e shumë të tilla, ne kuptojmë se individi influencohet nga familja (që është faktori gjenetik) dhe nga shoqëria (në të cilën jeton).

Rrjedhimisht në bazë të përbërjes gjenetike të bartur nga prindërit tanë dhe mjedisit në të cilin jemi rritur ose jetojmë, njeriu mëson dhe vepron sipas tyre. Prandaj e pamë të arsyeshme të trajtojmë, rëndësinë e të pasurit një shembulli për ta ndjekur dhe të qenurit një shembull për të tjerët njëkohësisht, si në aspektin islam ashtu edhe në atë psikologjik. E kjo nisur nga fakti se, gjithsecili prej nesh dëshiron të mësojë prej shembullit më të mirë të mundshëm. Por mënyra se si i zgjedhim ne shembujt, sa përpiqemi t'i ndjekim dhe zbatojmë veprimtaritë e tyre në përputhje me parimet e Islamit, është një çështje individuale, e cila duhet të merret në konsideratë prej gjithsecilit prej nesh.

Në Kur'an thuhet: "Po kështu, Ne ju kemi sjellë në mesin tuaj, një të Dërguar nga mesi juaj, i cili ju lexon ajetet Tona, ju pastron (nga gjynahet), ju mëson Librin (Kur'anin) e Urtësinë, dhe ju mëson ato gjëra që nuk i keni ditur".[1]

Prandaj, ne kemi nevojë për praninë e shembujve, që të shtojmë diturinë dhe besimin, ta besojmë dhe ta duam Allahun e të Dërguarin e Tij. Por, sa e ndjekim ne atë, jo vetëm me adhurimet e kryera, por dhe me cilësitë e tij si, besueshmëria, ndershmëria, e vërteta?

SA LARG KËTIJ SHEMBULLI JEMI DHE SA BËJMË QË TI AFROHEMI ATIJ?

Së pari, ne duhet të kuptojmë domethënien e fjalës "shembull" ose "model", e cila ka një rëndësi të madhe, si nga ana fetare-islame dhe ajo shkencore-psikologjike, sepse që kur je fëmijë e gjatë gjithë jetës, njeriu mëson në mënyrë të vazhdueshme. Shembull për t'u ndjekur quhet një person, i cili i jep një individi tjetër, një model për ta imituar, duke ndikuar te të tjerët pozitivisht ose negativisht. Ndërkohë, fjala arabe "usva" (shembull i mirë, model) do të thotë shembull ose model, që duhet respektuar dhe ndjekur njëkohësisht.

Për sa i përket besimit islam, "usva", (shembull), është një atribut që gjendet tek ata që posedojnë moral të lartë, si mirësi, drejtësi ose hijeshi. Shembull mund të jenë njerëz të rëndësishëm në jetën tonë si prindër, të afërm, bashkëmoshatarë, etj., ose dikush që individi nuk e njeh personalisht, por e ka hasur përmes medias. Në fillim ne marrim shembuj të tjerë, duke i përvetësuar karakteristikat e tyre, e pastaj në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi, mund të bëhemi shembull për të tjerët.

Për shembull, të rriturit mund të luajnë një rol kryesor në zhvillimin dhe jetën e adoleshentëve, e cila është një moshë kritike e zhvillimit të identitetit të tyre, i cili i shoqëron ata gjatë gjithë jetës.

Lind pyetja: Cili është dallimi mes shembullit të mirë dhe shembullit të keq?

Thjesht mendoni jetën tuaj, a nuk keni bërë shumë gjëra vetëm se miqtë tuaj po i bënin ato?! Nëse ata do të ndjekin "trendet", edhe ju do të donit të mos ndaheni prej tyre. Nëse ishte diçka e rrezikshme ose e dëmshme, ishin shembujt e miqve tuaj, që ju dhanë guximin të provonit ose të bënit të njëjtën gjë. A ishin ata një shembull i mirë apo jo?

Në një studim i kryer nga S. Kearney, M., & B. Levine, P. (2020) deklaron se fëmijët e sotëm kalojnë shumë, e më shumë kohë, në shkollë dhe duke lundruar në rrjete sociale, e shumë më pak kohë me prindërit, bashkëmoshatarët e tyre dhe të rriturit e tjerë[2]. Si rrjedhojë, sjellja

1. Kur'ani, El-Bekare: 151.

2. Shih: S. Kearney, M., & B. Levine, P. (2020). Role Models, Mentors, and Media Influences. *Future of Children*, *30*(1). Retrieved from https://files.eric.ed.gov/fulltext/EJ1262726.pdf

Fëmijët e sotëm kalojnë shumë e më shumë kohë në shkollë dhe duke lundruar në rrjete sociale, e shumë më pak kohë me prindërit, bashkëmoshatarët e tyre dhe të rriturit e tjerë. Si rrjedhojë, sjellja e një shembulli mund të jetë e mirë ose e keqe, prandaj ekziston një rrezik real i modeleve të këqija që çojnë brezin e ri në humbje. Kështu që, prindërit duhet të jenë të shqetësuar dhe të kujdesshëm se çfarë modelesh zgjedhin fëmijët e tyre për t'i ndjekur.

e një shembulli mund të jetë e mirë ose e keqe, prandaj ekziston një rrezik real i modeleve të këqija që çojnë brezin e ri në humbje. Kështu që, prindërit duhet të jenë të shqetësuar dhe të kujdesshëm se çfarë modelesh zgjedhin fëmijët e tyre për t'i ndjekur. Problemi është disi i ndërlikuar, nga vetë fakti se çështja e të qenurit i mirë ose i keq, është relative, si p.sh. për dikë mund të jetë ilaç, ndërsa për të tjerë mund të jetë helm.

Realisht, një shembull i mirë është ai që zotëron personalitet motivues dhe është i admirueshëm, udhëzues, i pasur me aftësi e arritje dhe sjelljet e të cilit janë të denja për t'u imituar. Për shembull, në përgjithësi, fëmijët përsërisin sjelljet pozitive që shohin tek prindërit e tyre. Shohim që fëmijët, prindërit e të cilëve kanë vetëvlerësim të shëndetshëm, ose kanë pasur sukses në shkollë, kanë tendencë që këto cilësi t'i zotërojnë edhe vetë.

Ndërsa shembulli i keq mund të jetë kushdo, ose edhe ndonjë person i njohur, të cilët me sjelljet dhe zgjedhjet e tyre mund të ndikojnë negativisht tek të tjerët, sidomos tek të rinjtë dhe adoleshentët. Ndonjëherë figurat publike të admiruara gjerësisht, mund të bëjnë zgjedhje personale të dobëta. Si rrjedhojë, modelet negative të roleve të tyre, mund të ndikojnë edhe tek ndjekësit e tyre.

Sipas një studimi, është vënë re që perceptimet e sjelljes së pahijshme të VIP-ve, ishin paralajmëruese të sjelljes së keqe të adoleshentëve[3]. Këto sjellje mund të përfshijnë sjelljen e papërshtatshme, dhunën, stereotipet e ndryshme, si dhe abuzimin me drogën e alkoolin, të cilat as nga ana fetare nuk janë të pranueshme. Gjithsesi nga fëmijët, prindërit e të cilëve pinë duhan, ka më shumë gjasa, që edhe ata vetë të pinë duhan, ose ata që janë rritur në shtëpi, në të cilën përjetojnë dhunë të shpeshtë në familje, ka më shumë të ngjarë të abuzojnë me bashkëshortët e tyre ose të abuzohen prej tyre.

POR CILA ËSHTË RRUGËZGJIDHJA?

Në një hadith, i Dërguari i Allahut (a.s) thotë: "Kush sjell një shprehi a traditë të mirë në Islam, do ta fitojë shpërblimin e saj, por edhe të shpërblimin e të gjithë atyre, që pas tij e punojnë atë, por pa ia zvogëluar aspak shpërblimin e tyre. Ndërsa kush sjell në Islam një shprehi a traditë të keqe, do të jetë barrë mbi të, por edhe barra e të gjithë atyre që veprojnë ashtu pas tij, pa iu zvogëluar aspak përgjegjësia dhe dënimi i atyre të tjerëve [4]."

Secili problem ka zgjidhje të shumta, të cilat ndihmojnë në parandalimin e zgjedhjes së gabuar të shembujve. Ne mund të flasim me fëmijët tanë si më poshtë:

T'iu kujtojmë fëmijës sonë se të gjithë njerëzit kanë cilësi të mira e të këqija dhe se çdokush është i gabueshëm. Gjithashtu, le t'i pyesim ata se çfarë mendimi kanë rreth sjelljes së modelit të tyre, ose se çfarë do të kishin bërë vetë ata ndryshe? T'iu kujtojmë atyre, se ata nuk ka pse të imitojnë gjithçka që shembulli i tyre vepron, por mund të zgjedhin atë çfarë që u pëlqen ose u përshtatet më së shumti. Më tepër, le t'ju sjellim atyre shembuj të njerëzve të komunitetit tonë, të cilët mendojmë se kanë cilësi pozitive dhe se mund të kenë një ndikim të mirë tek ata.

Ç'KUPTOJMË ME "IMITIM"?

Teoria sociale e mësimit sugjeron, se individët kanë më shumë të ngjarë të zgjedhin shembuj që ata i perceptojnë si të ngjashëm me veten e tyre[5]. Kjo teori është e dobishme në shpjegimin se si funksionon modelimi i shembujve, sepse njerëzit vëzhgojnë sjelljen e të tjerëve në situata të caktuara, dhe vërejnë rezultatet e atyre sjelljeve. Si pasojë, ata i përdorin këto njohuri për të formuar sjelljen e tyre, në kontekste të ngjashme me to. Të rinjtë, për shembull, mund të formojnë sjelljet e tyre bazuar në vëzhgimin e pasojave të veprimeve të të rriturve në mjedisin ku ata jetojnë.

CILAT JANË KARAKTERISTIKAT E SHEMBULLIT?

Karakteristikat e shembullit, gjithashtu kanë një efekt të fortë në prirjen e vëzhguesit për të imituar atë. Studime të shumta kanë demonstruar se vëzhguesit njerëzorë priren të mësojnë më shumë nga shembujt tërheqës, të pëlqyeshëm dhe prestigjioze, sesa nga modelet që nuk kanë këto karakteristika.[6].

Shembujt që janë tërheqës, të fuqishëm ose shumë të njohur, kanë më shumë gjasa të imitohen sesa shembujt që nuk janë të tillë. Veçanërisht, njerëzit e famshëm kanë gjasa të imitohen më tepër nga admiruesit e tyre, si tek modeli i flokëve, te veshjet, te mënyra e komunikimit, te sjellja shoqërore, etj.

Ç 'KUPTOJMË ME SHEMBUJ ME PROVOJË DHE PA PROVOJË?

Logjika e modelimit të shembujve me provojë është, që vëzhguesi të shikojë rezultate pozitive prej modelit/shembullit të tij.

3. Shih: Hurd, N. M., & Zimmerman, M. (2011). Role Models, Encyclopedia of Adolescence (pp. 2401). Retrieved from: *https://www.researchgate.net/publication/304035431_Role_Models*

4. Transmeton Muslimi, Rijadu Salihin 1, Imam Neveviu, fq.3, 118.

5. Shih: Bandura & Walters, (1963), siç citohet në S. Kearney, M., & B. Levine, P. (2020). Role Models, Mentors, and Media Influences. *Future of Children*, *30*(1). Retrieved from *https://files.eric.ed.gov/fulltext/EJ1262726.pdf*

6. Siç citohet në Hurd, N. M., & Zimmerman, M., (2011). Role Models, *Encyclopedia of Adolescence* (pp. 2403). Retrieved from: *https://www.researchgate.net/publication/304035431_Role_Models*

14

13

Në Kur'an thuhet: "Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun."[7] Thënë më thjesht, në fenë islame, Profeti Muhammed (a.s) është ndër shembujt më të mirë, ku ndjekja dhe imitimi i sjelljeve të tij, siç janë morali, sjellja dhe adhurimet e tij, të gjitha rezultojnë në një përfundim pozitiv, duke gjetur shpërblimin e veprave tona tek Allahu.

Ndërsa, logjika në përdorimin e shembujve të pakualifikuar, është që vëzhguesi të shohë se çfarë funksionon dhe çfarë nuk funksionon tek shembulli i tij, e pastaj të mësojë nga gabimet e shembullit, po ashtu edhe nga sukseset e tij. Për shembull, shumë prindër janë shumë të sinqertë dhe kanë një komunikim të mirë me fëmijët e tyre. Ata u tregojnë fëmijëve të tyre se duhet të jenë myslimanë të mirë dhe të zbatojnë ligjet e Islamit, duke ia mësuar këtë gjë, fëmijëve të tyre pa pushim. Ndërkohë që, në praktikë, veprimet e tyre shfaqin diçka tjetër. Si pasojë e kësaj, fëmijët janë të detyruar të zgjedhin vetë dhe të bartin personalisht përgjegjësinë e zgjedhjeve të tyre.

POR, CILAT JANË LIDHJET MIDIS SHEMBULLIT DHE IMITUESIT?

Lidhjet midis modelit shembull dhe imituesit janë admirimi dhe vullneti për t'u imituar nga ana e imituesit. Sidoqoftë, para se të admirojë e të vendosë të imitojë ndonjë model, imituesi duhet të jetë i vetëdijshëm dhe të ketë informacion për diçka në lidhje me atë model-shembull. Por, para kësaj vetëdijeje, duhet të ketë informacion për të. Sa më i madh të jetë sasia dhe shtrirja e informacionit në lidhje me personalitetet e suksesshme, aq më e madhe është mundësia për të gjetur një model të përshtatshëm.

Për shembull, Aishja (r.anha) ishte e martuar me Muhammedin (a.s), ajo kurrë nuk pati fëmijë, por kjo gjë, nuk e ndaloi atë që të arrijë objektivat e saj. Ajo është një nga transmetueset kryesore të Hadithit. Mund të përmendim edhe Nusajbe bint Ka'ab (r.anha), e cila është ndër të parat e konvertuara në Islam, e që ishte një nga shoqet (sahabet) e Profetit (a.s). Ajo mori pjesë në Betejën e Uhudit, u kujdes për ushtarët dhe konsiderohet infermierja e parë në Islam. Nga kjo mësojmë, se gratë mund të bëjnë gjithçka në këtë botë, madje edhe të marrin pjesë në një betejë.

7. Surja Ahzab, ajeti 21.

A MUND TË KEMI NJË SHEMBULL TË PERSONALIZUAR?

Ne jemi të ndërgjegjshëm që, sipas Islamit, qeniet më të mira njerëzore janë profetët. Pas tyre, qeniet më të mira njerëzore janë shokët, ndjekësit dhe pasuesit e profetëve. Sigurisht që shembulli më i madh i sjelljes shembullore, në çdo situatë të caktuar, është vetë Profeti Muhammed (a.s). Përveç tyre rreth nesh, nëpër botë ose në histori, ka shumë njerëz, të cilët janë për t'u marrë shembull dhe për të mësuar prej tyre, por çfarë mund të jetë më e rëndësishme ndër to?!

Në të vërtetë, përgjigja e kësaj pyetjeje është aq e gjerë sa vetë pyetja, sepse ajo ndryshon nga një person në tjetrin. Për ne si muslimanë/e, rëndësia e statusit të Profetit Muhammed (a.s) si një shembull është përcaktuar në Kur'anin Famëlartë dhe në Sunnet, e cila, rrjedhimisht, përbën një nga praktikat më kryesore për myslimanët. Profeti Muhammed (paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të), në lidhje me shembullin e mirë ose të keq ka thënë:

"Shembulli i shokut të mirë dhe të keq është sikur shembulli i shitësit të miskut (parfumit) dhe i farkëtarit. Shitësi i miskut ose do të të dhurojë ose do të të shesë parfum, ose (të paktën) do të vijë erë e mirë misku prej tij. Ndërsa farkëtari ose do t'i djeg rrobat, ose do të të vijë erë e keqe (nga thëngjilli)".[8]

Por, siç e kemi cekur dhe më parë, në mënyrë që t'i përvetësojmë karakteristikat e një individi, ne duhet t'i përvetësojmë dhe t'i personalizojmë ato duke i bërë pjesë të jetës sonë. Prandaj secili prej nesh pavarësisht moshës, gjinisë, apo çdolloj faktori tjetër, duhet të përpiqet që t'i personalizojë karakteristikat e shembullit/shembujve që zgjedh. Thënë ndryshe ne duhet t'i analizojmë, t'i përshtatim dhe t'i sjellim në jetë praktikat e shembullit që dëshirojmë të ndjekim, ashtu siç i ka hije vetes tonë.

Përgatitën:

Msc. Zamira Puka (Bushati),
Vaize - Myftinia Shkodër

Almeda Tusha
Studente, Këshillim dhe Udhëzim psikologjik, Stamboll, Turqi

8. Muttefekun alejhi, i transmetuar nga Ebu Musa el-Esh'ariu r.a.



I Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë:

"Shembulli i shtëpisë në të cilën i bëhet dhikër All-llahut dhe shtëpisë në të cilën nuk i bëhet dhikër All-llahut, është si shembulli i të gjallit me të vdekurin!"

(Buhariu, nga Ebu Musa)

MEJTEPI I IM... XHAMIA MURIQAN

Pak histori:

- Xhamia Muriqan, ndodhet në Njësinë Administrative "Ana e Malit", Shkodër.

- Përbëhet prej 130 familjeve myslimane.

- Fiset më të njohura janë: Oruçi, Lekaj, Nasuke, etj.

- Me lejimin e besimeve fetare në Shqipëri, pas vitit 1991 me iniciativën e besimtarëve dhe kontributin e të gjithë banorëve fillon ndërtimi i xhamisë së re.

- Në xhaminë e Muriqanit nga viti 1991 e deri më sot kanë shërbyer imam dhe mësues të mejtepeve: Ali Beçuku, Ali Hysja, Vehbi Dani dhe imami dhe mësuesi aktual, Ajet Suka.

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 18 kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në xhami në periudha të ndryshme nga viti 2002 -2021 është rreth 380 nxënës dhe nxënëse.

Takimi me nxënësit:

Sektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, në vazhdën e vizitave dhe takimeve të me nxënësit e xhamive që frekuentojnë rregullisht kurset-mejtepet e mësim-besimit, më 12 shtator 2021 drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni zhvilloi një takim-inspektimi me nxënësit e kursit fetarë në xhaminë Kiras.

Siç është bërë traditë tashmë, në takime të tilla, fillimisht, teologu Halluni u mbajti nxënësve të këtij kursi një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin si përçimin te brezi i ri mësimet e vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit.

Më pas, përgjegjësi i arsimit evidentoi nga afër ecurinë mësimore të nxënësve, pjesëmarrjen e tyre, si dhe procesin mësimor nga mësuesi dhe imami i xhamisë së Muriqanit, H. Ajet Suka.

TAKIM PUNE ME MYEZINËT E QYTETIT

Para drekën e të enjtes, më 9 shtator 2021, u zhvillu një takim pune me myezinët e xhamive të qytetit, me qëllim përmirësimin e punës së tyre fisnike si dhe rritjen e përkushtimit të tyre për një gjallërim të mëtejshëm, të veprimtarisë islame në xhami.

Përfaqësuesi i Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni gjatë fjalës së tij nënvizoi rëndësinë dhe rolin e madh që ka myezini në çdo xhami, i cili ka një pozicion me vlerë në thirrjen islame dhe lartësimin e fjalës së Zotit dhe të Pejgamberit (a.s) gjatë këndimit të ezanit në pesë vakte të ditës.

Teologu Halluni, duke e cilësuar ezanin më shumë si davet (thirrje) se sa një traditë u rikujtoi atyre disa nga udhëzimet e rëndësishme dhe rregulloren e xhamisë që kanë të bëjnë sidomos për këndimin e ezanit në formën më të mirë dhe të pëlqyeshme nga besimtarët dhe komuniteti.

Gjithashtu, ai u u ndal edhe te respektimi i orarit zyrtar të këndimit të ezanit për çdo kohë të namazit dhe kërkoi që myezini në bashkëpunim me imamin dhe këshillin e xhamisë të mirëmbajnë jetën fetare në xhami.

MYFTIU PRITI THIRRËSIN ISLAM SHQIPTAR NË AMERIKË, H. BURHAN FILI

Paraditën e së xhumasë, më 24 shtator 2021, Myftiu i Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt, thirrësin islam shqiptar me aktivitet të gjerë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, H. Burhan Fili.

Gjatë takimit të ngrohtë, Myftiu falënderoi z. Fili për kontributet e mëdha në përhapjen e vlerave islame kudo nëpër botë, si një zë i urtë dhe i ekuilibruar, miqësor e mesatar, që bashkon dhe afron në mesin e besimtarëve, duke përhapur dritën e urtësisë islame, kudo e me këdo.

Nga ana e tij, H. Burhan Fili u shpreh i gëzuar për këtë vizitë dhe dha disa këshilla dhe udhëzime, që lidhen edhe me kujtimin e mirë të Hoxhës së madh shqiptar, H. Vehbi Sulejman Gavoçi, si dhe amanetet e tij për përhapjen e kësaj drite të pashuar islame në trojet shqiptare.

Dy bashkëbiseduesit folën edhe për vlerën e botimeve të reja dhe domosdoshmërinë e regjistrimit të gjurmëve të më të diturve në mesin tonë, që punuan dhe vazhdojnë të kontribuojnë për të mirën e shoqërisë, fesë, atdheut e njerëzimit.

Dr. Mustafa Mahmud
1921-2009

“Urtësia e namazit qëndron në shembjen e mendjemadhësisë false, në të cilën jeton, në momentin kur bie në sexhde dhe balli yt prek dheun duke thënë me gjuhë dhe me zemër: Subhane Rabbijel-E'ala "Lavdi të qoftë Ty, o Zoti im i Lartësuar".

Ti, tashmë e di vendin tënd të fundit, dhe se ti je më i ulëti, ndërsa Ai është më i Larti. Ti je dhé përmbi dhé, ndërsa Ai është i Lartësuar mbi shtatë qiej.”

FALËNDERIM DHE MIRËNJOHJE

Myftinia Shkodër shpreh falënderim dhe mirënjohje të veçantë për të gjithë ata besimtarë, të cilët kontribuuan në lyerjen e ambienteve të dy xhamive të qytetit, xhamisë së lagjes Dërgut dhe xhamisë së "Dy Vajzave".

Allahu i Madhëruar i shpërbleftë me të mirat e Tij, në dynja dhe në ahiret!

Xhamia Dërgut

Xhamia e "Dy Vajzave"

A E DINI SE FAKULTETI I PARË I MJEKËSISË NË BOTË ËSHTË THEMELUAR NË KAYSERI NË SHEKULLIN E 13-TË?

Ndërtuar në vitin 1206 nga Giyaseddin Keyhusrev sipas amanetit të Gevher Nesibe Sultan, vajza e sundimtarit selxhuk Kiliçarslan II, medreseja dhe spitali ku mësoheshin shkencat mjekësore është qendra e parë në botë që ofroi së bashku arsim mjekësor dhe kujdes shëndetësor.

Gevher Nesibe Sultan kishte rënë në dashuri me krye spahiun dhe vëllai i saj Gyaseddin Keyhüsrev i I nuk i lejoi ata të martoheshin. Giyaseddin e dërgon krye spahiun në luftë dhe bëhet shkaktar i vdekjes së tij në betejë. Gevher Nesibe, e cila u sëmur, para se të vdes i la amanet vëllait për të ndërtuar një shtëpi të kujdesit shëndetësor në emër së saj që njerëzit të mund të përfitojnë falas nga këto shërbime. Giyaseddin, i cili u trondit shumë nga vdekja e motrës së tij, midis viteve 1204 dhe 1206 ndërtoi shtëpinë e kujdesit shëndetësor dhe medresenë mjekësore midis viteve 1210-1214. Shtëpia e

kujdesit shëndetësor gjithashtu ofroi shërbime në kurimin e sëmundjeve të brendshme, kirurgji, oftalmologji dhe spitalin e sëmundjeve mendore, ndërsa kishte edhe një farmaci.

Mjekët e njohur turq të asaj periudhe studiuan dhe dhanë mësim në këtë medrese.

Shtëpia e shëndetit dhe medreseja e Gevher Nesibe u organizua si një muze nga Universiteti Erciyes dhe në vitin 1982 u hap për vizitorët si Muzeu Historik Mjekësor i Gevher Nesibe.

(www.trt.net.tr/shqip)

A E DINI SE TRAGETI I PARË NË BOTË U NDËRTUA NGA TURQIT GJATË PERANDORISË OSMANE?

Në vitin 1850 u themelua kompania e transportit detar "Sirket-i Hayriyye", e cila filloi të ofrojë shërbime të transportit me anije më të mëdha për banorët e Stambollit.

Në vitet 1800, transporti në të dy anët e Ngushticës së Bosforit kryhej me barka të thjeshta. Në vitin 1840, anije të vogla filluan të ofrojnë shërbime transporti në Bosfor. Ndërkaq në vitin 1850 u themelua kompania e transportit detar "Sirket-i Hayriyye", e cila filloi të ofrojë shërbime të transportit me anije më të mëdha për banorët e Stambollit. Huseyin Haki Efendi, një nga drejtorët e kompanisë, ishte novator dhe kishte punuar me vite për një zgjidhje që do ta bënte më të lehtë transportimin e automjeteve. Ai kishte punuar me arkitektin e kompanisë për një vit mbi një anije të rrafshët pa kuvertë, e cila do të mund të lundronte para e prapa dhe në të cilën do të kishte pjesë të veçantë për njerëzit dhe kapakë në të dyja anët. Ata e dërguan këtë projektë në kantierin e anijeve në Angli, të cilët mbetën të mahnitur.

Ndërtimi i tragetit përfundoi në vitin 1871 për rreth 2 vjet dhe u quajt "Suhulet", që do të thotë lehtësi. Në vitin 1872, trageti "Suhulet", i cili bëri lundrimin e parë midis lagjeve Uskudar dhe Kabatas, shërbeu për 89 vjet në të dy anët e Ngushticës së Bosforit në Stamboll.

(www.trt.net.tr/shqip)

DEPUTETJA MYSLIMANE, SULTANA: ISLAMOFOBIA ËSHTË SHUMË E VËRTETË NË BRITANINË E MADHE

Deputetja muslimane në Britani të Madhe, Zarah Sultana shpërtheu në lot gjatë një fjalimi që mbajti të enjten ku foli për abuzimet që ka përjetuar që kur u bë politikane gjatë një debati parlamentar mbi përkufizimin e islamofobisë, raporton Anadolu Agency (AA).

Sultana, anëtare e Partisë Laburiste në parlament nga Coventry South tha se ajo kishte marrë mesazhe të ndryshme abuzive.

Duke folur me lotë, ajo tha: "Një person, për shembull, më shkroi, dhe unë citoj: 'Sultana, t'i dhe turma jote muslimane jeni një rrezik real për njerëzimin', një tjetër shkroi se unë jam një 'kancer kudo që shkoj' dhe së fundmi, ata thanë, 'Evropa do t'ju vjellë', kurse i treti më quajti 'simpatizant të terroristëve dhe llum i tokës', dhe kjo është e pastruar nga gjuha e tyre joparlamentare".

"Para se të zgjidhesha, isha nervoze se isha një grua muslimane në sytë e publikut", tha Sultana në Westminster Hall.

"Duke u rritur, kam parë abuzime ndaj të cilëve u nënshtroheshin muslimanët e shquar britanikë. E dija që ky nuk do të jetë një udhëtim i lehtë për mua", shtoi ajo.

"Dhe kur vajzat e reja më pyesin se si është, do të doja të thoja që kisha gabuar që shqetësohesha, se do të përballeshin me të njëjtat sfida si miqtë dhe kolegët e tyre jomuslimanë. Por, në kohën time të shkurtër në Parlament, kjo nuk është eksperienca ime.

"Kam zbuluar se të jesh një grua muslimane, të jesh e hapur dhe e majtë, do të thotë t'i nënshtrohesh kësaj breshërie racizmi dhe urrejtjeje", tha ajo.

"Nga disa trajtohem sikur të isha armik i vendit në të cilin kam lindur, sikur të mos i përkas", tha ajo.

Sultana tha se abuzimet që ka përjetuar u përkeqësuan kur kritikoi ish-kryeministrin Tony Blair për nisjen e "luftës të paligjshme" në Afganistan.

Ajo nënvizoi se "kjo islamofobi nuk vjen nga një vakum. Nuk është e natyrshme ose e rrënjosur. Kjo vërehet nga lart".

Sultana gjatë fjalimit të saj emocional tha se "Kur një llogari e ekstremit të djathtë në internet më vuri në shënjestër me abuzim racist, duke sugjeruar se muslimanët ishin ushtri pushtuese, një deputet konservator reagoi, duke mos i kritikuar ata për racizmin e tyre, por duke më ofenduar mua".

– Lufta kundër terrorit i vë muslimanët në shënjestër

Sultana tha se këtë të shtunë do të shënohet 20-vjetori i sulmeve terroriste të 11 shtatorit në SHBA dhe se "ky akt i tmerrshëm i vrasjes masive hodhi një hije të gjatë".

Ajo tha se kur ish-presidenti amerikan George Bush dhe Tony Blair filluan luftën kundër terrorizmit, ajo "hodhi një narracion të cilën shumë e përqafuan me gatishmëri: Muslimanët, kudo që ishin, u portretizuan si një kërcënim sigurie, të cilët kanë nevojë për disiplinë dhe shtypje".

Sultana nënvizoi se "ky ishte sfondi i luftërave katastrofike në Lindjen e Mesme, ku u treguan lidhje të rreme midis Irakut dhe sulmeve të 11 shtatorit, duke ofruar legjitimitet të rremë për një luftë që kishte të bënte më shumë me naftën sesa sigurinë e qytetarëve britanikë".

Ajo tha se shpresonte se gjërat do të shkonin drejt përmirësimit në të ardhmen ndërsa ajo mbante kokën ulur, por gjërat u përkeqësuan.

Duke iu referuar një artikulli të shkruar nga kryeministri britanik, Boris Johnson, Sultana tha: "Sot, kryeministri ynë tallet me muslimanët si 'kuti postare' dhe 'grabitës bankash'".

– Islamofobia është shumë e vërtetë në Britani

"Islamofobia është shumë e vërtetë në Britani sot", vazhdoi deputetja muslimane.

"Kjo është diçka që unë e di shumë mirë. Por, nuk mund të mposhtet në mënyrë të izoluar", theksoi Sultana.

Ajo potencoi se "Njerëzit që përhapin këtë urrejtje nuk synojnë vetëm muslimanët. Ata synojnë njerëzit me ngjyrë, hebrenjtë, synojnë komunitetin rom dhe udhëtarët. Ata synojnë emigrantët dhe refugjatët".

"Në solidaritet ka siguri dhe vetëm të bashkuar në përpjekjet tona ne do të mposhtim racizmin", shtoi ajo.

(www.radiojehona.al)

Pejgamberi (a.s) ka thënë:

1. **RUAJU PREJ HARAMEVE,**
   do të jesh njeriu më adhurues,

2. **KËNAQU ME ATË QË**
   TË KA CAKTUAR ALLAHU,
   do të jesh njeriu më i pasur,

3. **BËJI MIRË KOMSHIUT,**
   do të jesh besimtar,

4. **DËSHIROJI NJERËZVE**
   ATË QË DËSHIRON PËR VETËN TËNDE,
   do të jesh mysliman,

5. **MOS QESH SHUMË,**
   SE TË QESHURIT E TEPËRT
   mbyt zemrën!

(Transmetuar nga Imam Ahmedi dhe Tirmidhiu)

www.myftinia-shkoder.org

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek